



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2018:038623

Datë: 05.02.2019

Numri i dokumentit: 00219412

P.nr. 106/15

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË-Departamenti i përgjithshëm, me gjyqtaren Florije Zatriqi me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Hektor Bujupaj, në çështjen juridiko penale ndaj të akuzuarit A. Rr. për shkak se kishte për të kryer veprë penale legalizim i përmbajtjes së pavartet nga neni 334 par.1 të KPK – së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore -Departamenti për krime të përgjithshme në Pejë PP.nr.715/14 të datës 04.02.2015, në seancën e shqyrtimit gjyqësor me datë 20.11.2018, murr dhe shpalli, këtë:

A K T G J Y K I M

Kundër të akuzuarit :

A. RR. i biri i F. dhe nënës GJ., e vajzërisë M., i lindur me dt. 18.10.1985, , me profesion instruktor, i pamartuar, ka të kryer shkollën e lartë, i gjendjes së mesme ekonomike, i identifikuar me nr. të letërnjoftimit ..., Shqiptar, shtetas i R. së Kosovës gjendet në liri.

Konform nenit 363 par.1 pika 1.1 të KPPK-së.

REFUZOHET - Aktakuza

Gjëja se :

I akuzuari A. Rr.:

-Me dt. 28.10.2011, i pandehuri në Pejë, e vë në lajthim organin kompetent QRA – në, që në një dokument publik të vërtetoj një çështje të pavërtetë, në atë mënyrë që pasi që i pandehuri shkon në vendin e lartëcekur, me qëllim të regjistrimit të automjetit të llojit “Fiat Bravo”, ngjyrë të zezë meatlike, viti i prodhimit 2007, të cilin e regjistron me të gjitha të dhënat e lartëcekura, ku pas ekzaminimit forenzik nga njësia për ekspertim ka rezultuar se numri i karrocërisë të automjetit në fjalë ..., është i manipuluar si dhe pllaka (etiketa) metalike i mungon,

-me çka kishte për të kryer veprë penale *legalizim i përmbajtjes së pavërtetë nga neni 334 par.1 të KPK-së*.

Për shkak të parashkrimit të veprës penale, heqjes dorë të prokurorit të shtetit nga aktakuza në shqyrtim gjyqësor.

Shpenzimet e procedurës penale, bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

URDHËROHET që të pandehurit A. Rr., **ti konfiskohet përherëshëm:**

- I. Automjeti “Fiat Bravo” me ngjyrë të zezë viti i prodhimit 2007, me numër të targave ... dhe menumër të karrocërisë ZFA19800005059053, si dhe:
- II. Leja e Qarkullimit të automjetit CRA 049 – 3651, CRA – 0262844, si dhe VRD – ..., dhe atë në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore - Departamenti për krime të përgjithshme në Pejë, ka ngritë aktakuzë PP.nr.715/14 të dt.04.02.2015, ndaj të akuzuarit A. Rr. për shkak të veprës penale *legalizim i përmbajtjes së pavërtetë nga neni 334 par.1 të KPK – së*.

Në shqyrtimin gjyqësor të datës 20.11.2018, Prokurori i shtetit në fjalën përfundimtare ka deklaruar se: me provat materiale që u administruan provohet kjo gjendje faktike: fillimisht me dt. 22.10.2009, vetura e llojit “Fiat Bravo”, i cili ishte objekt i veprës penale, është paraqitur për doganim dhe atë duke u bazuar në dokumentin e vjedhur dhe të falsifikuar, librin origjinal të automjetit në gjuhën italiane që mban dt. 04.09.2009, vërtetuar që i njëjti është dorëzuar në doganë me dt.22.10.2009, në bazë të këtij dokumenti poashtu edhe në bazë të dokumnetit unik doganor DU, vërtetohet se automjeti ka poseduar numrin e karrocërisë ZFA ..., i cili numër pas ekzaminimit ka rezultuar se është i falsifikuar apo i manipuluar. Pra në asnjë rrethanë, vepra nuk ka mundur të kryhet me dt. 28.10.2011, ashtu siç është cekur në dispozitiv të aktakuzës, por kjo ka mundur të ndodh me dt. 22.10.2009 apo më parë. Është konstatuar se libri origjinal i automjetit është i vjedhur në vitin 2007, kjo është provë jo kontestuese mirëpo nuk kemi prova për tu bindur se i pandehuri e ka ditur apo ka mundur ta dijë se ky dokument është i vjedhur dhe i falsifikuar, kjo më së miri e provon fakti se i njëjti e ka dorëzuar në doganë dhe pastaj në bazë të këtij dokumenti ka kryer procedurat tjera, e që e rëndësishme është edhe homologimi i automjetit e ku vërtetohet rregullësia e automjetit. Andaj duke marr për bazë se në dispozitiv të aktakuzës duhet të jetë dt. 22.10.2009, e ku për këtë veprë penale *legalizimi i përmbajtjes së rreme nga neni 334 par.1 të KPK-së*, vepra është e dënueshme deri në 5 vjet burgim, gjej se me dt. 22.10.2014, ka arritur parashkrimi relativ i ndjekjes penale, i cili parashkrim, ka ndodh gjatë fazës parapenale. Duke marr për bazë këto fakte, prokurori i shtetit tërhiqet nga aktakuza e dt. 04.02.2015, me nr. PP/II.nr.715/2014, gjersa në anën tjetër i propozon gjykatës që të konfiskohen dokumentet: leja e qarkullimit të automjetit .. si dhe VRD 1070928, e poashtu edhe automjeti i llojit “Fiat Bravo” me ngjyrë të zezë, meqenëse janë të falsifikuara.

Kundër të akuzuarit të lartcekur, gjykata në kuptim të nenit 363 par.1 të KPPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me qenë se prokurori i shtetit hoqi dorë nga aktakuza PP.nr.715/14 të datës 04.02.2015 dhe nga ndjekja penale ndaj të akuzuarit A. Rr..

Edhe pse, ndaj të pandehurit është shpall aktgjykimi refuzues për shkak se prokurori ka hjek dorë nga aktakuza, siq u cek më lartë, gjykata konform dispozitës së nenit 282, 283 dhe 284 të KPPRK –së, konfiskoi: automjetin e llojit “Fiat Bravo” me ngjyrë të zezë, viti i prodhimit 2007, me numër të targave ..., dhe me numër të karrocërisë ..., si dhe lejen e qarrkullimit të automjetit si dhe VRD 1070928.

Gjykata, poashtu bazuar në dispozitën e nenit 284 të KPRK-së, urdhëroi që me këtë pasuri të administroj Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar (AAPSK) në Kosovë,

Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate konform nenit 454 par.1 të KPPK-së.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**NGA GJYKATA THEMELORE NË PEJË-DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM
P.nr.106/15 dt. 20.11.2018.**

Bashkëpunëtori profesional

Hektor Bujupaj

Gj y q t a r j a

Florije Zatriqi

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.

Numri i lëndës: 2018:038623
Datë: 05.02.2019
Numri i dokumentit: 00219412